REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNAL - LIPJAN
DREJTORATI I INSPEKTORATIT

DREJTORATI I INSPEKSIONIT

Datë :	**03.03.2023**
Referencë	**11-344/2**
Për :	**Imri Ahmeti-Kryetar i Komunës**
Kopje:	**Diamant Bytyqi-Nënkryetar i Komunës**
Kopje:	**Lulëzim Qerimi-Nënkryetar i Komunës**
Nga:	**Flamur Sylejmani - Drejtori i Inspekcionit**
Lënda :	**Raporti i muajit-shkurt**

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Inspektorët e trafikut:

Inspektorët e trafikut kanë ndjekur agjendën mujore për punët brenda kompetencës së tyre. Objektivë e inspektoreve të trafikut ka qenë inspektimi i kompanive të autobusëve dhe i auto-taksive si dhe kombi-taksi ilegal. Janë bërë disa pika kontrolli në fshatin Rufc i Ri në rrugën "Ismet Asllani", në rrugën "Bajram Gashi" në relacionin Gadime-Lipjan, në rrugën "Haredin Bajrami" dhe "Komandant Kumanova". Gjatë inspektimit, inspektorët e trafikut kanë realizuar procesverbale, gjoba mandatore si dhe janë konfiskuar targa dhe libreza të automjeteve me të cilat ushtrohej veprimtaria taksi pa licencë.
Nga Policia e Kosovës njësia në Lipjan kemi pasur ftesë për aksion të përbashkët dy ditor me datë 13-14.02.2023. Objektivi i aksionit ishte përafërsisht i ngjashëm me agjendën e caktuara në planifikimin e inspektoratit. Nga i cili aksion janë realizuar procese të shumta dhe është zbatuar ligji për të gjitha parregullsitë.
Inspektimi i rrugës "Avdi Kelmendi" dhe rrugës për në fshatin Konjuh, kompania KEDS ka prerë asfaltin në të dy rrugët pa pasur pëlqim nga organet gjegjëse për të intervenuar në prishjet në rrjet. Sipas zyrtarëve të KEDS intervenimi ka qenë emergjent, sepse disa fshatra kanë mbetur pa furnizim me rrymë shkak i dëmtimit të kabllos elektrike në këto rrugë.
Inspektimi i rrugëve "Malet e Sharrit", "Hamdi Bislimi" në të cilat kompania e ujësjellësit ka intervenuar për shkak të rrjedhjeve të ujit. Mirëpo ato pjesë të rrugëve dhe trotuareve i ka asfaltuar ashtu si i është dhënë urdhëresa.

Inspektori i ambientit:

Përveç agjendës së planifikuar inspektori i mjedisit-ambientit ka dalë në teren për të inspektuar dhe për t'ju përgjigjur ankesave të qytetarëve në fshatrat Gadime e Ulet, Vrellë e Magurës në lidhje me problemet me mbyllje të rrjetit të kanalizimit, mbyllje të gypave për ujëra atmosferik, ndotje të ajrit me tym nga skarat (në qytet) ndotje të pllakave tek Sheshi "Adem Jashari" gjatë renovimit të lokaleve, si dhe pengesa tjera me rrjedhje të ujërave në objekte në bashkëpronësi. Të gjitha rastet janë shqyrtuar, janë dhënë urdhëresa, ku disa janë zbatuar dhe disa janë në proces të zgjedhjes sipas afateve.
Gjithashtu një subjekti i cili ka pasur punë të kontraktuara nga KFOR-i për vendosje të gypave për kabllo elektrik gjatë kryerjes së punimeve në fshatin Vrellë të Magurës është hedhur material betoni në gypin që përcjellë ujërat atmosferik. Subjekti është përgjigjur menjëherë urdhëresës së inspektorëve, problemi është sanuar.
Një qebaptoreje në rrugën "Lidhja e Prizrenit" i është ndalu përdorimi i skarës për pjekje për shkak të pengesës me tym, qebaptores i është dhënë urdhëresa për largim të skarës nga hapësira publike.

Kompanisë “Pastrimi” i është dhënë vërejtje që piken e transferimit të mbeturinave të mbajnë pastër dhe të gjithë mbeturinat e shpërndara nga era të grumbullohen. Urdhëresa është duke u zbatuar sepse nga inspektimi i radhës është parë duke u punuar në grumbullimin e mbeturinave të shpërndara.
Ndaj një biznesi në Lipjan investitor i objekteve të larta me shumë njësi banimi është shqiptuar gjobë me aktvendim për mos zbatim të urdhëresës dhe mos plotësim të kushteve të lejes mjedisore komunale.

Inspektorët e tregut:

Kanë inspektuar në vazhdimësi subjekte të ndryshme afariste si: sallonet e ondulimit dhe të zbukurimit, mishtoret, qebaptoret, marketet ushqimore, për regjistrimin e bizneseve, pranimeve teknike, kontrollimi i çmimeve, vendosja e flamujve përkatës.
Sipas kërkesave të bizneseve janë bërë gjithsej 13 pranime teknike të bizneseve se i plotësojnë kushtet për të ushtruar aktivitetin e tyre biznesor.
Prioritare ka qenë edhe ndalimi i shitjes jashtë tregut.
Gjithashtu është inspektuar tregu të mos krijohen vështirësi për këmbësoret në trotuare, nuk është lejuar asnjë lloj shitje jashtë tregut. Inspektim i vazhdueshëm është bërë edhe në tregun e mobileve dhe të kafshëve.

Inspektorët e ndërtimit:

Periudhë kohore në të cilën nuk realizohen ndërtime me ritëm të lartë. Për kundër kësaj është realizuar një vetërrenim dhe janë realizu procese për raste të ndërtimit pa leje. Dhe janë realizu vizita inspektuese me kërkesë të ndërtuesve për fazat ndërtimore.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Punët dhe aktivitetet e realizuara gjatë muajit shkurt janë:

Inspektimi i auto-taksive në qytetin e Lipjanit.
Inspektimi-kontrollimi i firmave të autobusëve në qytet dhe fshatrat.
Inspektim i rrugëve dhe trotuareve në qytet dhe jashtë qytetit.
Inspektimi i auto-taksive në Aeroportin “Adem Jashari” në Vrellë
Janë inspektuar marketet sallonet e ondulimit dhe te zbukurimit, mishtoret, qebaptoret, marketet ushqimore etj.
Janë kontrolluar çmimet e artikujve ushqimor në rafta dhe çmimet e arkës gjatë pagesës.
Shqyrtimi i ankesave të qytetarëve në teren me kohë sipas ligjeve dhe rregulloreve komunale.

STATISTIKAT

Inspektorët	Gjithsej inspektime	Inspektime me procesverbal	Pranime teknik	Fletëparaqitje	Vendosje të shiritave zyrtar	Kallëzim penal	Vërejtje, njoftime	Rënim i objektitit	Të hyra nga pranimet teknike	Punë me palë, kërkesa	Lendet e pranuara	Lende te pezulluara, ekzekutuara gjygjesore	Gjoba mandatore	Barazim i të hyrave	Biznese të paregjistruara	Biznese pa pranime teknike të lokaleve afariste	Konfiskim i targave dhe librezës	Menaxhim I tregjeve dhe i kontratave për ndërtim	Aktvendime, ndalesa, urdhëresa, vendime ,shkresa	Inspektim me polici	Ankesa të konsumatorëve
Biznesi	169	35	13						250.00€	44	17				9		11	12	28		
Ambienti	27	7					2			6	7	1	1							3	
Ndërtimi																					
Trafiku	96	20					21			19	1		2				3	8	4	18	
Gjithsej	292	62	13				23		250.00€	69	25	1	3		9		14	20	32	21	

DISKUTIMET PUBLIKE

Diskutime publike nuk kemi mbajtur.

TAKIME TË TJERA

Takimet janë mbajtur me qytetarë, pronar të bizneseve, pronar të ndërtimeve, me taksistë.

SFIDAT

Inspektimi i bizneseve të paregjistruara, pa pranime teknike.
Inspektimi i rrugëve dhe trotuareve në qytet si dhe mbrojtja e hapësirave gjelbëruese, ndalimi i hedhjes së mbeturinave inerte në tokat bujqësore.
Inspektime të auto-taksive si dhe i firmave të autobusëve në qytet dhe në fshatra si dhe inspektimi i taksive ilegal në ANP.
Inspektimi i ndërtimeve pa-leje ndërtimore dhe parandalimi i tyre duke ndërmarr masa ligjore, si dhe inspektimi i objekteve me leje ndërtimore.

REKOMANDIMET

Rekomandojmë qytetarët të cilët hasin në ndonjë parregullsi e cila trajtohet me kompetencë nga Inspektorati Komunal të na njoftojnë në Drejtorin e Inspektoratit në mënyrë që ti evitojmë.